

## DEKLARATË SHTYPI E SHOQATËS “PRONËSI ME DREJTËSI “ PËR PËRGJIGJEN E BANKËS BOTËRORE

Në vijim të Apelit që Shoqatat “Pronësi me Drejtësi” dhe “Bregdeti” i kanë drejtuar me 31 mars 2013 institucioneve ndërkombëtare, ndër të tjerë dhe z. Philippe Le Houerou, zv. President i B.Botërore për Europën, shoqatat kanë marrë më 21 maj 2013 përgjigjen e Bankës Botërore nënshkruar nga znj. Kseniya Lovovsky, drejtuese aktuale e Bankës Botërore në Shqipëri. Meqenëse problemi i pronës ka rëndësi parimore dhe kombëtare dhe Banka Botërore është një ndër "këshilltarët" kryesorë të Qeverisë për këtë çështje, mendojmë që përgjigjen për znj. Lovovsky dhe z. Philippe Le Houerou, ta publikojmë jo vetëm në faqen internet të shoqatës (defendingproperty.com) por edhe përmes gazetave.

Në përgjigjen e dt 21 Maj znj. Lovovski i referohet shqetësimit të shoqatave mbi politikën e Qeverisë Shqiptare dhe të Raportit të Bankës Botërore 62519 AL, si dhe përgjigjes së Bankës Botërore të 23 Janarit 2013 (shif: defendingproperty.com/shqip/letra-te-shoqates/ ). Në lidhje me propozimin legjislativ (projekt-ligjin e shoqatave) lidhur me çështjet e pronësisë dhe të kthimit të pronës në Shqipëri, znj. Lovovski sqaron se, ndryshe nga sa supozojnë shoqatat, Banka Botërore nuk ka mundësi, në kuadrin e mandatit të saj të ndërhyjë në ligjet e ndonjë Shteti. Banka botërore pret që shoqatat të punojnë në kuadrin e procesit legjislativ dhe të strukturave egzistuese për të kontribuar në zhvillime legjislative të drejta.

Kjo përgjigje që në sipërfaqe duket e drejtë dhe parimore në thelb maskon qëndrimin abuziv të Bankës Botërore ndaj problemit të pronës dhe ankesave tona që në fillimet e veprimtarisë saj në Shqipëri. Problemi me znj. Lovovski dhe me të gjithë drejtuesit e mëparshëm të Bankës Botërore në Tiranë nuk është mungesa e kompetencës për të këshilluar në fushën ligjore, por ujdia e tyre me drejtuesit e politikës shqiptare të cilët këto 22 vite "demokraci" kanë zbatuar dhe vazhdojnë të zbatojnë me konsekuencë strategjinë e Katovicës. Ne mendojmë se Znj. Lovovski dhe Banka Botërore po abuzojnë me tolerancën tonë dhe të popullit shqiptar në përgjithësi. Ne kërkojmë nga Banka Botërore korrigjimin e rekomandimeve të gabuara , koordinim me instanca të tjera ndërkombëtare si për shembull me Këshillin e Evropës dhe Gjykatën e Strasburgut dhe respektim, në rekomandimet që Banka Botërore i jep Shqipërisë, të vendimeve të Strasburgut mbi pronat (grupi i rasteve Driza dhe Puto dhe vendimi pilot i korrikut 2012)!

Abuzimi i Bankës Botërore qëndron pikërisht në mospranimin e problemit bazë që është **detyrimi i shtetit demokratik për të kthyer tek i zoti pronën e grabitur nga diktatura**, konform legjislacionit dhe angazhimeve ndërkombëtare të marra nga shteti shqiptar që në fillim të viteve '90. Abuzimi tjetër qëndron në mospranimin nga ana e Bankës Botërore se lëmshi i krijuar qëllimisht në çështjet e pronësisë zgjidhet duke respektuar prioritetin e të drejtave të pronarëve të shpronësuar nga diktatura komuniste (=kthim i pronave) dhe duke kompensuar me vlerë të plotë pronarët për rastet kur prona përdoret për nevoja publike. Fatkeqësisht pas 1991 politika shqiptare, ka zbatuar platformën e Katovicës. Me parulla populiste herë të majta e herë të djathta, në ekonomi dhe në politikë është ricikluar një klan i përzgjedhur nga regjimi i mëparshëm, i cili ka përvetësuar pronat që duhet t'i ishin kthyer të zotërve.

Ne kemi kërkuar dhe do vazhdojmë të kërkojmë që vjedhja e pronave e organizuar nga politikanët pas vitit 1991, **të mos vazhdojë të financohet nga Banka Botërore**. Problemi i pronës zgjidhet thjesht e pa faturë financiare konform parimeve morale dhe kushtetuese demokratike nëse do të zbatohet neni 181 i Kushtetutës tonë. Ne jemi të bindur se kjo realizohet me projekt-ligjin që kemi propozuar. Ky projektligj njëkohësisht trajton e zgjidh dhe pasojat e shkaktuara gjatë periudhës "demokratike"22 vjeçare. Ne i kemi kërkuar Bankës Botërore të na ndihmojë në këtë drejtim, duke kërkuar ekspertizë ligjore e kushtetuese pranë Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës, për projektligjin e shoqatës. Sipas përgjigjes së znj. Lovovsky, Banka Botërore nuk mund të "ndërhyjë" në këtë drejtim ndërkohë që ajo nuk hezitoi të ndërhyjë për të shembur shtëpitë e pronarëve autoktonë në trojet turistike të Jalës, thjesht për të plotësuar interesat e klaneve që grabisin trojet turistike.

Ky qëndrim selektiv dhe tendencioz bën që ne ta akuzojmë Bankën Botërore për keqmenaxhim ose, për të përdorur gjuhën diplomatike, keqkëshillim në procesin e kalimit të Shqipërisë nga diktatura në demokraci. Këtë e dëshmon dhe situata katastrofike e ekonomisë shqiptare. Ekonomia është në gjendje alarmante pasi borxhi publik ka kaluar kufirin maksimal. Në këtë fallcitet demokratik të nisur para 22 vjetësh, problemi më madhor është problemi i pronës dhe në këtë problem Banka Botërore ka luajtur rol kryesor. Kjo sepse çdo pronë që nuk kthehet përbën faturë financiare. Kjo sepse moszgjidhja e problemit të pronësisë është pengesë madhore për investime serioze dhe zhvillim të mirëfilltë të ekonomisë shqiptare. Projektligji ynë e zgjidh shumë mirë këtë situatë por Banka Botërore me këtë përgjigje justifikohet me anën procedurale dhe e anashkalon thelbin e problemit.

Përgjigja e fundit e Bankës Botërore është episodi i fundit i një seri shkëmbimesh publikuar në faqen internet të shoqatës ([www.defendingproperty.com](http://www.defendingproperty.com)). Në një seri letrash, shoqatat, në mënyrë të përsëritur kanë sinjalizuar dhe kundërshtuar qëndrimin negativ të Bankës Botërore ndaj pronarëve autoktonë.

Shkurtimisht i rikujtojmë Bankës Botërore se: Anarkia aktuale e titujve të pronësisë është situata më e rëndë që ka njohur populli shqiptar që nga mesjeta përfshi edhe periudhën e pushtimit otoman, atë të pushtimit fashist italian në 1939 dhe më tej atij nazist gjerman. Asnjë nga këta pushtues nuk i ka mohuar popullit shqiptar të drejtën mbi pronën e trashëguar. Kjo shpjegon ndër të tjera se megjithë pushtimet e njëpasnjëshme shqiptarët ruajtën identitetin e tyre. **Po, prona e trashëguar është identitet kombëtar dhe ABC e demokracisë.** Shteti para 1944 i ka administruar pronat në mënyrën më moderne europiane, që është model edhe për sot. Diktatori Enver Hoxha i shtetëzoi pronat, por i ruajti dokumentat e shpronësimeve dhe nese hapen regjistrat e shtetëzimeve dhe miratohet projektligji që ju propozojmë problemi i pronës zgjidhet më së miri. Ndërkohë Raporti i B.Botërore që është adaptuar plotësisht në Planin e Veprimit të Qeverisë mohon identitetin dhe origjinën e pronës. Heshtja e Bankës Botërore ndaj kërkesave tona është një thyerje e rëndë morale dhe një shkelje flagrante e të drejtave të njeriut. Për këtë situatë tragjike që prej vitit 1991 ka shkaktuar mijëra të vrarë dhe konflikte sociale, që rriten çdo ditë, përgjegjësi historike dhe morale mbajnë drejtuesit e politikës shqiptare dhe kryesisht ata të PD dhe PS por edhe Banka Botërore, që me heshtje po mbështet anarkinë dhe korrupsionin aktual me pronat.

Ne asnjëherë nuk do të pajtohemi me qëndrimet e gabuara të Bankës Botërore dhe politikanëve të papërgjegjshëm e të pangopur, që duke na mohuar pronën e trashëguar mohojnë identitetin tonë kombëtar. Ne shpresojmë akoma në (mirë)kuptimin nga ana e Bankës Botërore të këtij problemi. Mbështetja përmes rrjeteve sociale e mbarë shqiptarëve dhe pronarëve, veçanërisht e rinisë patriotike e emigracionit shqiptar si dhe e shtypit shqiptar e të huaj është esenciale.

**Për kryesinë e Shoqatës Kombëtare të të Shpronësuarve “Pronësi me Drejtësi”**

**Rrapo Hajredin Danushi**